

Lumturia Compass.

Me Compass realizimi i një dëshire është tepër i thjeshtë.

Mund të zgjedhësh sipas nevojës sate, financime të shpejta dhe me avantazh, dhe të marrësh një hua Compass në një kohë të shkurtër dhe me shumë pak dokumenta.

Ja se çfarë të nevojitet.

LETËRNJOFTIMI

Me letërnjoftim (dokument identiteti) nënkuptohet Pasaporta ose Karta e Identitetit e vlefshme. Karta e Identitetit është një dokument personal njohje që mund të merret nga çdo qytetar i huaj i cili ka një lejeqëndrim të rregullt dhe vendbanim të regjistruar në gjendjen civile në territorin italian. Për lëshimin është e nevojshme t'i drejtohem Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës ku kemi vendbanimin.

KODI FISKAL

Për leximin e kodit fiskal është e nevojshme të paraqitni Kartën Rajonale të Shërbimeve (Kartën Shëndetësore). Kodi Fiskal shërben për identifikimin për qëllime fiskale (taksash) për personat fizikë që janë me vendbanim në territorin italian. Është i dobishëm për qytetarët e huaj për arsye të ndryshme, ndërmjet të cilave shërben për regjistrimin në Shërbimin Sanitar Kombëtar (Servizio Sanitario Nazionale) ose për të hapur një llogari rrjedhëse bankare. Lëshohet së bashku me lejen për punë si vartës, nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore italiane jashtë shtetit. Të huajt që nuk kanë një Kod Fiskal, sepse kanë një Lejeqëndrim që nuk shërben për aktivitete pune, mund ta marrin atë tek Zyrat që varen nga Agjencia e Taksave (Agenzia delle Entrate) e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

DOKUMENTI I TË ARDHURAVE

Mos harro të marrësh me vete dokumentin e të ardhurave të fundit që ke, për shembull: fletëpagesën (busta paga) e fundit për punëtorët vartës, Modelin Uni.Co për punëtorët autonom (është një nga formularët që përdoren në Itali për të deklaruar të ardhurat e personave fizikë, dhe është i rezervuar për ata që marrin të ardhura nga tokat, ndërtesat, për pjesëmarrje në fitime, punë të varur, punë autonome me shkëputje ose të vazhdueshme, nga ndërmarrjet dhe nga pensioni), kuponi i pensionit për pensionistët.

LEJEQËNDRIMI

Është e nevojshme të paraqitësh Lejeqëndrimin/Kartën e qëndrimit. (Permesso/Carta di soggiorno). Lejeqëndrimi duhet t'i kërkohet Kuestorit të provincës në të cilën i huaji gjendet, brenda tetë ditësh nga momenti i hyrjes në Itali dhe duhet të ketë një motivacion të njëjtë me atë të vizës. Procedura e re për dhënien dhe ripërtëritjen e Lejeqëndrimit (i detyrueshëm për të huajt, fakultativ për qytetarët e një vendi anëtar të Bashkimit Evropian) i jep mundësi qytetarëve të huaj që të tërheqin një "kit" që përmban formularët, të Zyrat Postare, Komunitat dhe të Sindikatave që japin këtë shërbim.

Për çdo informacion, telefono në numrin jeshil nga e hëna deri të premten, ora 9.00 – 19.00, ose konsulto faqet në internet.



www.compassonline.it



FINANZIAMENTI
COMPASS
GRUPPO BANCARIO MEDIOBANCA

Ne i përkrahim me forcë projektet tuaja.